



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 05-400-19781/15
Kaçanik, 30.06.2015

Në bazë të nenit 42.2(b) dhe (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 e datës 04 Qershor 2008) në shqyrtimin e Draftit të Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Kaçanikut për vitet, 2016-2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30 qershor 2015, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS
SË KAÇANIKUT PËR VITET 2016-2018

1. Me këtë Vendim, APROVOHET Drafti Kornizë, më tekstin e mëtejshëm: **Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet: 2016-2018.**
2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet: 2016-2018, lëshohet në procedurë të Debatit publik më qytetarë.
3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi, Financa, dhe Zhvillim të zhvillojë procedurën e Debatit publik më qytetarë dhe më Ekzekutivin e Komunës dhe pas saj rezultatet e diskutimit publik t'ia prezentojë Kuvendit të Komunës, më qëllim të finalizimit të draftit Kornizë.
4. Pjesë përbërse e këtij vendimi është: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut, për vitet 2016-2018, e hartuar nga Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e përmbledhur në gjithsej 55 faqe me numër të protokollit 01 Nr. 05-400-19781/15.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.



Kryetari i Kuvendit
Xhevdet Gashi